



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i dëgjimit publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në fshatin Orllan

Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, hapi dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, në fshatin Orllan, e ku pjesëmarrës ishin edhe drejtori i drejtorisë së Inspeksionit, Alban Zeka dhe drejtori i drejtorisë së Administratës, Shuajb Blakçori.

Drejtori Osmani tha se “Korniza Afatmesme Buxhetore hartohet duke u bazuar në Qarkoren e Parë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave për të gjitha organizatat buxhetore përfshirë edhe komunat në nivel të Republikës së Kosovës, dhe këtu përcaktohen limitet buxhetore për organizatat buxhetore të cilat kanë projeksionet buxhetore të Ministrisë së Financave, ne sot jemi këtu të marrim kërkesat dhe propozimet e juaja në mënyrë që gjatë hartimit të KAB, të jemi sa më gjithëpërfshirës në realizimin e kërkesave së qytetarëve, duke pasur parasysh që gjithmonë kërkesat e juaja janë më të mëdha se mundësitë buxhetore, por ne do të prioretizojmë ato në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë qytetarë.

Komuna e Podujevës për këtë vit e ka një buxhet afër 31 milion euro, në bazë të Qarkores së Parë Buxhetore është një lajm i mirë që do të kemi një rritje të buxhetit, prej përafërisht 2.6 mil euro dhe normalisht kjo rritje shpërndahet në paga, në komunal, në subvencione, mallra dhe shërbime por edhe në investime kapitale (ku këtu pritet të kemi një rritje rreth 1 mil euro).

Ne sot jemi këtu për ju, për të dëgjuar kërkesat e juaja, sepse fshati Orllan me fshatrat përreth ka shumë kërkesa dhe nevoja të qytetarëve që duhet të realizojmë, mirëpo këtu duhet të përmendim që shumë projekte infrastrukturore janë duke u realizuar në këtë pjesë si ndërtimi i rrugës Herticë-Turuçicë, rruga për fshatin Kalaticë, si dhe ndërtimi i rrugëve tjera brenda fshatit që në vlerë janë rreth 100 mijë euro nga buxheti i komunës.

Gjatë kësaj periudhe janë disa kërkesa që nuk kemi patur mundësi të u përgjigjemi viteve të kaluara do të bëjmë përpjekje maksimale të u përgjigjemi viteve 2025, dhe gjithashtu do të projektojmë edhe projekte tjera për vitin 2026-2027.

Ju faleminderit për vëmendjen, kjo ishte vetëm një fjalë hyrëse sqaruse sa i përket planifikimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, deri në fund të qershorit ne jemi të detyruar të miratojmë, KAB është një dokument strategjik i cili ka këto orientimet e përgjithshme, mirëpo buxheti miratohet ne muajin shtator, kështu që deri atëherë ne do të takohemi prap në mënyrë që të jemi sa më gjithëpërfshirës në buxhetin 2025, fjala është e juaja” përfundoi drejtori Osmani.

Drejtori i shkollës së Orllanit- Naim Bajrami, falënderoi drejtorët që janë prezentë, dhe gjithë bashkëfshatrët e tij me rrethinë, ai tha se kërkesat e mia lidhen kryesisht me shkollën.

Kërkesa e parë është fasadimi i jashtëm i shkollës, mandej kemi një rrugë të pa asfaltuar, një kënd të lojrave i mungon shkollës është kërkesë e nxënësve, është ndoshta e vetmja e shkollë që nuk ka fushë sporti, të cilën do ta shfrytëzojnë 11 fshatra këtu.

Ne kemi problem shumë edhe me qenë endacak, ju lutem bëjeni një zgjidhje, pastaj pjesa e sipërme e urës që të dërgon për Bërvenik, Kushevicë dhe Brainë është pa trotuar, duhet të kemi të paktën 150 metër trotuar, se mundet më pësu ndonjë fëmijë.

Shkollat që i kemi në Rakinicë dhe Turuçicë, janë në gjendje të mirë, me pak investim mund të shfrytëzohen prej Policisë apo Ushtrisë, gjithashtu në këtë pjesën e këndit lartë të shkollës, mandej të lagjia e Kangjajeve, është një rrugë pa shtruar në gjendje jo të mirë më gjatësi rreth 500 metër, nëse ka mundësi ta rregulloni, ndërsa për drejtorin e inspeksionit kam një pyetje, a ka mundësi që në pjesën e ndërtimit nëse lejohet me ligj pse mos me na dhan leje, sepse është peisazhi më i bukur dhe ja vlen të shfrytëzohet, gjithashtu objektin e vjetër të komunës meqenëse kulmi i ndërrohet është mirë me ba dhoma nalt për sportistët, salla të konferencave apo ndonjë sallë filmi, sallë leximi, sepse objekti është jashtëzakonisht i mirë, edhe njëherë ju falënderoj si drejtori i shkollës që shumicën e kërkesave rreth shkollës që i kam patur ju i keni realizuar” përfundoi drejtori Bajrami.

Banor i fshatit Orllan - janë disa çështje që i adresoj drejtori, mirëpo kërkesa që dua të theksoj është trotuari prej urës së Orllanit e deri të rruga e Pazarit, afër xhamisë me gjatësi rreth 300 metra, fëmijët çdo ditë frekuentojnë at rrugë, sepse ajo në përballkalim është e ngushtë e lëre me kalu andej fëmijët. Puna e ndërtimit që e hapi drejtori i shkollës, sepse Orllani ka një pamje të mirë dhe duam të investojmë në turizëm, pavarëisht që tani kemi ujin dhe rrymën, leja e ndërtimit na mungon, për zonën e parë jemi në rregull, por për zonat tjera të na mundësoni, pasi që ne jemi zonë turistike dhe turizmi më së paku po zhvillohet në zonën tonë, ata persona të cilët kanë prona tani skanë mundësi të ndërtojnë, komuna e Podujevës e ka pasuri këtë zonë, me pak investime dhe me ide të qëlluara mund të ndryshojë turizimi, mungon një vend kamping për turistë, Orllanit i mungon shumë edhe fusha e sportit, historikisht këto fshatrat përreth, janë kanë qendër e lojave, primare është asfaltimi i rrugës Orllan-Ballaban , ka shumë frekuentime, shkaku që është tu rregullu rruga e Podujevë-Prishtinë, kena vendosë shpesh sinjalizues por po i largojnë, por duhet me ba një studim të thellë, është rrezik sepse secila veturë që mundet me ra

prej rruge përfundon në ujë, duhet të vendosen rrethoja, në mahallën tem është 400 m kanalizimi që duhet me u ba sepse është në sipërfaqe, e sidomos verës kundërmon shumë, sepse ai kanalizimin shkon drejt në liqen, deri te ura poshtë është rrjeti i kanalizimit, mandej rruga “Bajrush Sillova” ka shumë, janë banorët rezidencë, ka nevojë shumë me u rregullu, ose psh “Brainë” zhavori është shumë i nevojshëm, rruga e Rakinicës është përmend shumë moti, aty janë dy fermerë shumë të suksesshëm, mandej ka ndërlihdje edhe me pjesët tjera të komunitetit, kisha dashte me u lidh te kulla e “Zahir Pajaziti” aty neve na mungon një ciceron, këtu vinë shumë turista, mirëpo aty dikush duhet me prezantu historinë, është edhe muzeu i cili duhet të hapet aty, ndërsa problemi ynë kryesor është mirëmbajtja e plazhës gjatë sezonës së verës, ne vitin e kalum me koordinim të komunitetit me financim privat kena pagu një kompani, na duhen 2-3 punëtorë për mirëmbajtje të liqenit gjatë sezonës së verës, sepse vet po e kemi të pamundur të jemi gjithmonë aty për pastrim.

Drejtori i shkollës, Naim Bajrami thekson nevojën për kolektorin e ujërave të zeza, kisha kërkua urgjentisht një kamion me pastru, qajo gropa septike lidhet në liqen, ne skemi të drejtë me u lidh me kolektor. Shumicën e rasteve banorët nuk i kanë leju me u lidh, sepse ministria po na shkakton konfuzitet me vendimet e veta.

Nuhi Dili- banor i Orllanit , një pyetje drejtorit të Inspeksionit, ne kemi pasur me ndërtu mirëpo na kane ndalu, një ditë duke kalu në fshatin Ballaban i pash ndërtimet, nëse atyne ju lejojnë ndërtimet pse neve nuk na lejohen, pse skemi të drejtë të investojmë në tokën tonë, ju falënderoj për sjelljen e ujit, kërkesa tjetër është për shtrimin e rrugës së vllaut tem dëshmor “Ekrem Dili”, ajo që 10 vite përmendet për tu shtruar ne asfalt, ndërsa as me zhavor nuk është shtruar komplet , është rreth 300 metër, është pastaj rruga e Rubinit që të dërgon te varrezat e lagjes.

Banor i fshatit të Turuqicë-fillimisht ju falënderoj për kohën që keni gjetur dhe vendin që keni përzgjedhur të mbani këtë takim në këtë lokalitet, ju shihet dukshëm që i keni rritur investimet në këtë zonë, gjë e cila më herët ka munguar, por nevojat ende janë shumë të mëdha.

Jam kthyer nga Londra pas 40 viteve për me jetu në Turuqicë, jemi 7 vllazër që kemi që kemi 17 hektar tokë ne jemi të interesum me investu ne bujqësi dhe në fermë, ne kemi problem me rrymë, ne kemi trafon mirëpo kemi problem me rrymë të dobët, kam bërë disa kërkesa në Podujevë e Prishtinë mirëpo nuk më janë përgjigjur, mirëpo une kam edhe një kërkesë, nga gurthyesi e deri të kufiri, rreth 2 km, në atë pjesë nuk ka shancë asnjë zjarrfikës me hy, sepse po e shohim që shpesh kemi zjarre, a keni ndonjë plan për ta shtruar atë rrugë.

Labinot Salihu – jam nga fshati i Orllanit por jetoj në Bardhosh, jam shumë i kënaqur por vetëm për rrugën “Ekrem Dili” ka filluar me u shtru në zhavor mirëpo u mbet në gjysmë, jemi 6 familje, kemi qenë në komunë, por nuk na kanë dhanë përgjigje, me veturë te vogël nuk ka mundësi mundësi me kalu.

Fitim Gjukolli – vi nga fshati i Brainë, por jetoj në Bardhosh, ju falënderoj për kohën që keni nda me ardh me na i dëgju hallet tona, ne kemi problem prej para lufte nuk ka rrugë në zhavor,

që nga pas lufta nuk është investu as një milimetër në at rrugë, rruga quhet “Rizah Zhujani” prej xhamisë së Braniës duhet të ngitësh lartë kah lagjia Zhujani, që na viti 2019 bëjmë kërkesë për më u asfaltu mirëpo deri tani asnjë nuk është bërë, vitin e kaluar kam aplikuar grant për lajthi, këtë vit pres me u realizuar granti, i cili është mbjellja e 2 hektarëve lajthiave, me traktor është shumë e vshtirë me kalu e lëre me me veturë, gjithashtu nëse keni mundësi edhe disa shtylla elektrike 3 fazëshe me na i siguru sespe janë nevoja bazike.

Drejtori i drejtorisë së Inspeksionit- Alban Zeka, i falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje në këtë dëgjim buxhetor, dhe të gjithë ata të cilët parashtruar pyetje dhe kërkesa, ai tha se çështja e ndërtimit është diskutuar edhe vitin e kaluar, mirëpo kjo problematikë siç e dini që vendimi i vitit 2013, që pamundëson ndërtimet në këto zona, në është dashte edhe hartën zonale me kriju në atë formë që me ju përshtatur atij vendimi, është ba një përpjekje e drejtorit të Urbanizimit me bashkëpunëtorë në mënyrë që me e liru at zonë, mirëpo nuk është pranuar në at formë, dhe është kthyer nga ministria dhe është dashtë më përpunuar prap, ju siç edhe e cekët për fshatin Ballaban, që po lejohet ndërtimi, mirëpo duhet ta dini gjithashtu që ky fshat i përket me njësi administrative komunës së Prishtinës, në dy komunat i përgjigjemi të njëjtës ministri dhe dy komunat punojmë më rregullativa të saj, aty buzë ujit që janë në zonën e parë, nuk ka mundësi të merret leje mjedisore për ndërtime, na kemi bërë disa takime me zyrtarë të Ministrisë, ende është ai vendim dhe fatkeqësisht nuk lejohet çështja e urbanizimit, andaj për aq sa janë këto kritere ju kisha lut me i respektu, ata që kanë ndërtu i kemi trajtu e disa janë për gjykata, e disa të tjerë në procedura, mos mendoni që kanë kaluar pa u marrur me ta, ju cekët edhe kërkesa tjera siç ishin rrugët, të cilat janë vështirë të përfshihen të gjitha në buxhet, Arbeni përmendi edhe fshatin nga unë vi, kërkesë e cila une ballafaqohem çdo ditë me ta, janë një numër i madh i tyre që jetojnë në Podujevë, mirëpo tani dëshirojnë të kthehen në fshat, çka unë e mirëkuptoj mirëpo rruga ka një gjatësi të madhe dhe një teren bukur të vështirë, prej lagjes Kangaj e deri te varrezat janë dikund rreth 4 km, rrugë goxha e gjatë, po shpresojmë që vitin e ardhshëm do ta trajtojmë aq sa kemi mundësi, të paktën me zhavor, ndoshta e trajtojmë me dy faza, çka është me e lehtë edhe për neve, në kemi arrit të kemi një memorandum bashkëpunimi me ministrinë e Infrastrukturës, dhe falë bashkëpunimit me ta kemi vendos si prioritet rrugën nga Llalleshët e deri te shkolla, këtu ku është ndërprerë asfalti, deri te Smajli, kanë dal inxhinierët kanë parë terrenin, kanë kalkuluar sa përafërisht është kostoja dhe me aq sa ne dimë do të jetë rreth 190 mijë euro, e ajo rrugë po lidh rajonin, kemi dy lidhje prej Hertice në Turuçicë, një prej xehrores e deri te Kulla e Zahir Pajazitit, dhe këndeje rrugët tjera po vazhdojnë të cilat i kena marr me prioritet vitin e kaluar, une uroj dhe shpresoj që të përfundojmë edhe rrugët tjera në fshatin Orllan me fshatrat përreth, dhe të shohim pastaj me prioritet të cilat na dalin, kështu që ju falënderoj për pyetjet dhe jam i gatshëm të përgjigjem prap në çështjet që janë në domenin e drejtorisë sime.

Fatlum Osmani, - disa sqarime i dha drejtori i Inspeksionit lidhur me ndërtimin e rrugëve, ndërsa e vërteta është që kemi një numër të madh të projekteve që kanë një kosto të madhe që i kemi në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, që 3 vite radhazi jemi në bashkëpunim me këtë ministri për këto rrugë, përveç dy rrugëve të cilat i përmendi drejtori Zeka, është edhe rruga

Kushevica-Nishevcë, edhe ajo është në procedurë, tash vetëm është lidh dhe së shpejti do të fillojnë punimet, bëhet fjalë për një mori rrugësh të cilat janë duke u kryer në këtë zonë, edhe në si komunë me buxhetin tonë i kemi nda këtë vit 110 mijë euro ku do të ndërtohen disa rrugë, pa dyshim që do të jetë pjesë e buxhetit çdo vit Orllani, ka fshatra që për nga numri i banorëve mund të jenë më të mëdha se Orllani por nuk janë pjesë e buxhetit për çdo vit, mirëpo Orllani duke i pasur shumë specifika të cilat u përmendën do të jetë pjesë e buxhetit të komunës dhe do të jetë prioritet i Komunës.

Ne gjatë viteve të fundit e kemi prioritetuar shume fushën e arsimit, dhe do të vazhdojmë ta prioritetizojmë, ne në fushën e Arsimit investimet kapitale i kemi gjetur me 110 mijë euro, ndërsa tani i kemi 1 mil e 600 mijë euro, ndërsa në vitin 2025 pritet të kalojë mbi 2 mil euro, mirëpo komuna e madhe ka numër të madh të institucioneve arsimore dhe do të ketë edhe ndërtime të shkollave, qerdheve të cilat natyrisht një pjesë të buxhetit, në shkollën e Orllanit është investuar mirëpo ende do të investohet, në KAB e kemi edhe ndërtimin e sallës së sportit të edukatës fizike ku do ti shërbejë nxënësve dhe komunitetit. Ndërsa objektet e shkollave në fshatin Rakinicë dhe Turuçicë është e vërtet që janë duke u përdorur, do të shikojmë mundësinë në përdorimin e të mirës së komunitetit, objekti i vjetër i Shkollës është me Ministri të Kulturës, ai është objekt i mbrojtur i trashëgimisë kulturore, shumë shpejt edhe do të restaurohet në mënyrë që të shfrytëzohet varësisht në bazë të nevojave të cilat do të vendosim bashkarisht, kemi biseduar edhe me drejtorin është mirë të shfrytëzohet për qerdhe, sepse Orllani ka nevojë të ketë një qerdhe, ku është e rëndësishme në zhvillimin ekonomik, sepse përveç edukimit të fëmijëve është e rëndësishme të punojnë të gjithë për një zhvillim më të mirë ekonomik. Kërkesat tjera kenë në fushën e lejitimit të ndërtimit, planin Rregullativ, pajtohemi dhe jemi duke menduar, që ky rajon dhe çdo pjesë e komunës së Podujevës do të ketë Planin Rregullativ, është harta zonale e cila ka miratuar Komuna e Podujevës, tash veprojmë në kuadër të hartës, në bashkëpunim me Ministrinë dhe ligjet në fuqi, sepse ne e dim që shumë resurse turistike të cilat janë shkatërruar i ka shkatërruar ndërtimi, dhe jo mungesa e turizimit, mandej e përmende ciceronin te Kompleksi memorial i “Zahir Pajazitit”, ai monument nuk është në menaxhimin e Komunës, mirëpo ne Agjencionin për Mbrojtjen e Monumenteve, është si kërkesë shumë e arsyshme mirëpo duhet të bisedojmë me ta, ndërsa sa i përket shtegut të ndërtimit për ecje edhe këtu ndërlidhet me çështjen e ndërtimit dhe mënyrës se si zgjedhen, por pa dyshim që në Orllan duhet të investohet në fushën e Turizimit, ndërsa disa kërkesa që ishin për kanalizim ne do ti adresojmë të drejtoria e Shërbimeve Publike, ku kemi rritje të buxhetit për trajtimin e kanalizimeve dhe ne do të bëjmë përpjekje maksimale me u trajtu, dhe natyrisht që duhet t’i kemi prioritet edhe për shkak të mbrojtjes së liqenit te Batllavës.

Një çështje tjetër ishte mirëmbajtja e Liqenit, ne tani kemi themeluar një Ndërmarrje Publike “Eko Llapi” e cila ka kaluar procedurat administrative por është në fillimet e saja si ndërmarrje, së shpejti gjatë muajit Korrik do të fillojë funksionalizimi, do të shikojmë si mundësi të marr disa detyra por mos e merrni si premtim , mirëpo për vitin 2025, pa diskutim që do të punohet shumë në çështjen e mirëmbajtjes nga kjo Ndërmarrje Komunale Publike që të mbrojmë ambientin, një

çështje tjetër të cilët e përmendët është çështja e rrymës, ku me të vërtet është e vështirë për ata të cilët dëshirojnë të investojnë të mos kenë energji elektrike, dihet që kjo është kompetencë komplet e KEDS-it, kompani private, ku neve si komunë nuk na përgjigjet, por ajo ka obligim ligjor që çdo qytetari i cili merr leje të kqyet duhet t'i ofrojë energjinë elektrike, pastaj ndërtimi i rrugës i cili është e pakalushme "Rizah Zhojani" e cila është e pakulshme, mirëpo është rruga goxha e gjatë, mirëpo unë e evidentova, gjithashtu ju inkurajojë të vini edhe në komunë ti diskutojmë në drejtorin e Shërbimeve Publike.

Nëse nuk keni pyetje tjetër me kaq dua të mbyll këtë takim, duke ju falëndruar secilin për pjesëmarrje dhe sugjerimet e juaja.

Podujevë,

11.06.2024







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve të fshatit Orllan me rrethinë në dëgjimet e Kornizës Afatmesme
Buxhetore 2025-2027

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	Halim Bajrami	Orllan		
2	ARIBEH MUSA	ORLLAN		
3	Ilir Dili	ORILLAN		
4	HALIL MUKESHRI	TURUCI		
5	Saliq Haxhiu	Orllan		
6	ZABIKOT SALLHU	ORILLAN		
7	Senad Haxhiu	Orllan		
8	Armin Haxhiu	ORILLAN		
9	FITIM XHUKOLLI	BRAINE		
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				

29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

Vërejtje: Njoftohen të gjithë pjesëmarrësit e takimit se të dhënat e listës së nënshkrimeve dhe fotot përdoren për postime në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës!

Podujevë

05.06.2024